



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Mars 2022

Nr: 135

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E REZULTATIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS, QARKU DURRËS, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE
TË DATËS 6 MARS 2022 DHE DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË
ZJ. EMIRIANA HIQMET SAKO**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 123 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, në bashkinë Durrës, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie.

Pasi përfundoi procesi i dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi, për Kryetarin e Bashkisë Durrës, nga të 4 KZAZ-të e kësaj bashkie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të nxjerrë rezultatin për këtë bashki, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123, të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 123, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.



Data: 9 Mars 2022

Nr. 135

“Për miratimin e rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, qarku Durrës, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë zj. Emiriana Hiqmet Sako”

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr. 21, me vendimin nr. 507, datë 7.3.2022, KZAZ nr. 22, me vendimin nr. 359, datë 7.3.2022, KZAZ nr. 23, me vendimin nr. 339, datë 7.3.2022 dhe KZAZ nr. 24, me vendimin nr. 328, datë 7.3.2022, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik dhe rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 22, KZAZ nr. 23 dhe KZAZ nr. 24, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ me përjashtim të QV-së nr. 1416, të ZAZ nr. 22, ku me vendim të KZAZ-së përkatëse kutia e fletëve të votimit u shpall e parregullt.
- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë/nuk u vërejtën mospërputhje :

KZAZ 21 Bashkia Durrës

QV me probleme	Problemi	GN	TPR	SISTEM
1328	Fletë votimi të papërdorura	321	32	32

KZAZ 22 Bashkia Durrës

QV me probleme	Problemi	GN	TPR	SISTEM
14581	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	674	674	674
14581	Fletë Votimi të gjetura në kuti	130	130	130

Në QV- në nr. 14581 u konstatua diferencë me një numër prej 544 midis numrit të zgjedhësve që kanë votuar dhe fletëve të votimit të gjetura në kuti. Nisur nga fakti që fletët e votimit të gjetura në kuti janë 126 të vlefshme dhe 4 të pavlefshme dhe nga fakti në këtë qendër votimi zgjedhës në listë janë 674, vrehet një gabim material i kryer nga Komisioni i Qendrës së Votimit në procesverbalin e mbylljes, në të cilin në vend të numrit të zgjedhësve që kanë votuar është shënuar numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, qarku Durrës, me shifrat e korrigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, të plotësuar nga Grupi i Numërimit të Votave.



Referuar nenit 123, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 123 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të japë mandatin e Kryetarit të Bashkisë Durrës, zj. Emiriana Hiqmet Sako, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE



Për kandidatët për kryetar të bashkisë Durrës

			Gjithsej
1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	68.842
		gra	29.724
2	Fletë votimi të papërdorura		195.457
3	Fletë votimi të dëmtuara		84
4	Fletë Votimi të gjetura në kuti		68.833
5	Vota të pavlefshme		1.863
6	Vota të vlefshme		66.970

Nr	Kandidatët për Kryetar		Gjithsej
1	Ardian Mihal Muka	Sh-L	19.876
2	Emiriana Hiqmet Sako	PS	39.157
3	Luan Haki Hoti	PD	7.937
Gjithsej vota të vlefshme			66.970